



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

### KONTRATË PËR PUNË

*KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj. Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njëren anë;*

*Dhe*

*KONTRAKTORI "SIB" Shpk nga Veriqi, Komuna e Istogut, të cilën e perfaqëson z. Sabit Mslijaj, me Nr. Rexh. Biznesi, 70533014 (në vazhdim "Kontraktuesi"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:*

#### **TITULLI I KONTRATËS:**

#### **NDËRTIMI (SANIMI) I RRUGËVE NE SYRIGANË**

Nr. I prokurimit	633-18-3479 -5-2-1 / C 103
Nr. I brendshëm	633 / 018 / 027 / 521

#### **Neni 1 Lënda:**

*1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:*

#### **NDËRTIMI (SANIMI) I RRUGËVE NË SYRIGANË**

*Neni 2 Çmimi*

*2.1 Çmimi total i punëve per aktivitetin e prokurimit NDËRTIMI (SANIMI) I RRUGËVE NË SYRIGANË është: 8.299,53 €, dhe me fjalë:  
/Tetëmijëedycindenëntëdhjetëenëntë/ €*

*2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit te kontratës.*

*2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të ... Veçanta të kontratës.*

### *Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës*

*3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:*

- Marrëveshja e kontratës;*
- Kushtet e Veçantës të Kontratës;*
- Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;*
- Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;*
- Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);*
- Plani për menaxhimin e kontratës*
- Proçesverbalet e Vizitës në teren e mbikqyresi*

*3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetër, dhe në raste të paqartësisë ose divergencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.*

### *Neni 4 Komunikimet*

*4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.*

*4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për*

*pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.*

**4.3** Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" "do të" interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

**4.4** Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinalë, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinalë për Kontraktuesin.

*Për Autoritetin Kontraktues:*

*Për Kontraktuesin:*

<i>Emri:</i>	<i>Zizë Bujupaj</i>	<i>Emri:</i>	<i>"SIB" Shpk Sabit Muslija</i>
<i>Pozita:</i>	<i>Zyrtar Përgjrgjës i Prokurimit</i>	<i>Pozita:</i>	<i>D re j t o r</i>
<i>Nënshkrimi:</i>		<i>Nënshkrimi:</i>	
<i>Data:</i>		<i>Data:</i>	<i>24.07.2018</i>
<i>Vu la</i>		<i>Vu la</i>	

**PJESA III E KONTRATES**      *kushtet e veçanta*

*KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.*

*Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

<b>Kushtet e Përgjithshme të Kontratës</b>		<b>Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK</b>
<b>Përshkrimi i Neni.</b>	<b>Nr.</b>	
<i>Ligji zbatueshëm dhe gjuha</i>	<b>2.1</b>	<i>Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksoni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.</i>
	<b>2.2</b>	<i>Gjuha e përdorur do të jetë gjuha SHQIPE</i>
<i>Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit</i>	<b>7.2</b>	<i>Shuma minimale e sigurimit do të jetë: sipas Ligjeve ne fuqi qe rregullojne lemin e siguracioneve.</i>
<i>Programi</i>	<b>8.1</b>	<i>Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët nga data e Nënshkrimit të kontratës.</i>
<i>Siguria e ekzekutimit te kontratës</i>	<b>10</b>	<i>Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10% e shumës totale te kontratës, ne nje afat kohëzgjatje prej 60 ditësh, nga data e nënshkrimit të kontratës.</i>
<i>Fillimi i punëve</i>	<b>17.1</b>	<i>Data e fillimit do të jetë mënjëherë pas nenshkrimit te kontratës, gjegjësisht me datë kur menaxheri i kontratës e përcakton në ditarin e punes dhe Librin ndertimor si dhe PLANIN PËR MENAXHIM TË KONTRATËS.</i>
<i>Përfundimi i punimeve</i>	<b>17.2</b>	<i>Data e përfundimit të punëve dhe instalimet do të jetë: 30 ditë, nga dita e nënshkrimit te kontratës</i>

Dëmet e likuiduara	19.1	<p>Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë llogaritura për ditë dhe atë 0.25 % për ç'do ditë vonesë te paarsyeshme.</p> <p>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për gjitha Punët është 10 % e çmimit final të Kontratës.</p>
Inspektimi dhe	22.1	<p>Kompanija mbikqyrëse NPN "ING-IDEA" &amp; "LIRIU", nga Suhareka e kontraktuar nga Autoriteti Kontraktues, është mbikqyrese e kontratës, e cila ka per obligim ta percjellë rrjedhen e punimeve dhe te raportoje AK-në per rrjedhat dhe permbushjen me sukses te kontrates. Ose</p> <p>Drejtorati perkates i inicimit te kerkeses do të caktoje një zyrtar per implementim te kesajë kontrate.</p>
Pagesat	24.1	<p>Pagesat do te bëhen në euro ashtu si raporton Organi Mbikqyrës, bazuar ne raportin e mbikqyresit, pas kryerjes së punimeve për situacionet perkatëse.</p>
Përmirësimi defekteve	31.1	<p>Periudha garantuese e defekteve është 365 ditë, pas perfundimit te instalimit, bazuar ne deklaratën e kontraktorit.</p>
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.1	<p><b>KOMUNA E ISTOGUT – DREJTORATI PERKATES I INICIMIT TË KËKESËS DHE IMPLEMENTUESI I PROJEKTIT</b></p>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore - Departamenti për çështje Ekonomike - Prishtinë.</p> <p>Palet duhet te deklarohen para nenshkrimit te kontratës – për KOMPETENCËN, për kontestet eventuale Gjykata apo Arbitrazhi.</p>